



KOMUNA E KAMENICES

Profili Ekonomik i Komunës së Kamenicës



Fjala e Kryetarit



Të nderuar,

Kam kënaqësinë që të prezantoj para jush një profil të qartë e potencial të zhvillimit ekonomik të Komunës së Kamenicës. Ky profil reflekton natyrën dinamike si dhe mundësitë e prezantuara për investim e zhvillim të Komunës së Kamenicës.

Vendndodhja jonë strategjike, infrastruktura e zhvilluar mirë dhe fuqia punëtore kontribuojnë ndjeshëm në suksesin tonë ekonomik. Qyteti shërben si një qendër për inovacionin dhe sipërmarrjen, duke nxitur një klimë që inkurajon si bizneset e vogla ashtu edhe investimet më madhore të kenë sukses. Për më tepër, qyteti ynë ka bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturë duke krijuar një mjedis të favorshëm për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Angazhimi ynë për qëndrueshmërinë dhe ndërgjegjen mjedisore e biznesore reflektohet në iniciativat tona për të përmirësuar këtë. Këto përpjekje jo vetëm që kontribuojnë në mirëqenien e komunitetit tonë, por gjithashtu tërheqin iniciativa e ide biznesi duke përforcuar pozicionin tonë si një qytet i përgjegjshëm dhe që mendon për të ardhmen.

Spektori i turizmit luan një rol të rëndësishëm në ekonominë tonë. Kjo jo vetëm që nxit bizneset tona lokale, por gjithashtu rrit gjallërinë kulturore të komunitetit tonë.

Për sa i përket zhvillimit të fuqisë punëtore, ne kemi e do të vazhdojmë të bashkëpunojmë ngushtë me institucionet arsimore lokale dhe qendrat e formimit profesional për të siguruar një fuqi punëtore të aftë dhe të adaptueshme. Ky investim në kapitalin njerëzor është thelbësor për të mbështetur rritjen tonë ekonomike dhe për të tërhequr biznese të reja që kërkojnë një fuqi punëtore të kualifikuar.

Ndërsa shikojmë nga e ardhmja, Kamenica mbetet e përkushtuar për të nxitur një ekonomi gjithëpërfshirëse dhe inovative. Komuna e Kamenicës gjithashtu ka punuar edhe në mbështetjen e bizneseve ekzistuese të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Kamenicë. Në të njëjtën kohë, si institucion zotohemi që të jemi të qasshëm e afër atyre që duan të kontribuojnë duke ofruar secilën ndihmë të nevojshme.

Unë ju ftoj që të shihni nga afër dhe të eksploronin mundësitë që ofron komuna jonë. Angazhimi i përbashkët sjell suksese të përbashkëta.

Sinqerisht,
Kadri Rahimaj
Kryetar i Komunës së Kamenicës



Kamenica e gjelbër, digjitale, e zhvilluar

Vizioni i Kamenicës

Komuna e Kamenicës – thesar natyre, vend i mirëqenies dhe i balancimit shoqëror, mjedisor dhe ekonomik.

Misioni i Kamenicës

Të zhvillojmë ekonominë lokale në mënyrë të balancuar, duke rritur cilësinë e jetës për të gjithë banorët e komunës sonë, duke ofruar shërbime efikase dhe efektive. Të rrisim komunikimin dhe bashëkpunimin me qytetar e biznese vendore, duke ju ofruar mbështetje në të bërit biznes për rritjen e kapaciteteve prodhuese, në segmente ku tregu është më atraktiv. Ta njohim rolin kyç që kanë të rinjtë në fushën e teknologjisë informative, dhe ta vëmë në funksion të zhvillimin ekonomik lokal. Të kujdesemi për natyrën dhe resurset natyrore, duke shtuar kapacitetet me potencial turistik për turizmin rural.

Demografia

22868 banorë

Gjinia

Femra 11,177 ose 48.87%
Meshkuj 11,691 ose 51.12%

Mosha

0-9 vjec	2,401 banorë
10-19 vjec	2,845 banorë
20-29 vjec	3,546 banorë
30-39 vjec	2,820 banorë
40-49 vjec	2,775 banorë
50-59 vjec	3,471 banorë
60-69 vjec	2,863 banorë
70-79 vjec	1,516 banorë
80+ vjeç	641 banorë

Etnia

Shqiptar	20,558 banorë
Serb	1,888 banorë
Turq	3 banorë
Boshnjak	12 banorë
Rom	379 banorë
Ashkali	1 banorë
Goran	10 banorë



Vendbanimet

58 vendbanime


57 vendbanime rurale
1 vendbanim urban



Berivojcë, Bllatë, Boscë, Bratilloç, Busavatë, Dajkoc, Dazhnicë, Desivojcë, Feriqevë, Gmicë, Gogolloc, Gragjenik, Grizimë, Gjyrishec, Hajnoc, Hodonoc, Hogosht, Kamenicë, Karaqevë e Epërme, Karqevë e Poshtme, Kolloleq, Kopernicë, Koretin, Kostadincë, Kranidell, Kremenatë I, Kremenatë II, Krilevë, Lajciq, Leshtar, Lisockë, Marocë, Meshinë, Mocar, Muciverc, Novosellë, Petroc, Polickë, Qarrakoc, Rahovicë, Rogaqicë, Ruboc, Sedllar, Strellicë, Shahiq, Shipashnicë e Epërme, Shipashnicë e Poshtme, Tërstenë, Topanicë, Tugjec, Vaganesh, Velegllavë e Epërme, Velegllavë e Poshtme, Vriqec, Zajqec, Zhujë

Te tjerë 17 banorë

Sipërfaqja e Komunës 417 km²



Buxheti i Komunës: 14,523,817.00euro

Arsimi

- Numri i shkollave – 21
- Numri i çerdheve - 2
- Numri i fëmijëve në edukim të hershëm - 144
- Numri i nxënësve në shkolla fillore/ të mesme - 3418



Shëndetësia

- QKMF - 1
- QMF - 3
- Përçindja e imunizimit
- Njësitë në fshatra (AMF) - 17



Qasje në shërbimet bazike

<i>Ujësjellës</i> 61.56%	<i>Mbeturina</i> 69.01%	<i>Internet</i> 97.9%	<i>Kanalizime</i> 35.78%
-----------------------------	----------------------------	--------------------------	-----------------------------

Tre sektorët më të mëdhenjë (sipas vlerësimit të komunës)

Turizmi

Bujqësia

Teknologjia informative


Demografia

Sipas të dhënave të fundit zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës¹ të vitin 2024 Komuna e Kamenicës aktualisht ka 58 vendbanime, ku jetojnë 22,868 banorë dhe moshë mesatare është 31.5 vite.

Tabela 2. Struktura e moshës

Mosha	0-9 vjec	10-19 vjec	20-29 vjec	30-39 vjec	40-49 vjec	50-59 vjec	60-69 vjec	70-79 vjec	80+ vjec
Nr.banorëve	2,401	2,845	3,546	2,820	2,775	3,471	2,863	1,516	641

Struktura organizative e Komunës



Buxheti

Buxheti i komunës së Kamenicës i paraqitur në tabela të të hyrave dhe shpenzimeve

Tabela 3. Të hyrat

Burimi i të hyrave	Vlerësimi 2022	Vlerësimi 2023	Vlerësimi 2024	Vlerësimi 2025
Granti i përgjithshëm	4,071,728.00	5,360,529.00	5,976,303.00	6,452,896.00
Granti i Arsimit	4,659,800.00	4,483,745.00	5,440,648.00	5,433,969.00
Granti i Shëndetsisë	1,278,384.00	1,397,854.00	1,892,973.00	2,041,687.00
Shërbimet sociale Rezid.	177,250.00	183,000.00	197,272.00	220,000.00
Gjithësej Grantet	10,187,162.00	11,425,128.00	13,507,196.00	14,148,552.00
Të hyrat vetanake	883,430.00	956,771.00	1,016,621.00	1,134,072.00
GJITHËSEJ BUXHETI	11,070,592.00	12,381,899.00	14,523,817.00	15,282,624.00

Tabela 4. Shpenzimet

Struktura e shpenzimeve	Vlerësimi 2022	Vlerësimi 2023	Vlerësimi 2024	Vlerësimi 2025
Paga dhe medijtja	7,642,413.00	7,566,476.00	8,980,426.00	9,185,435.00
Mallra dhe shërbime	1,769,200.00	1,943,000.00	2,274,278.00	2,422,098.00
Shpenzime komunale	211,800.00	238,000.00	254,000.00	262,000.00
Subvencione	343,000.00	447,000.00	648,000.00	885,000.00
Investime Kapitale	1,104,179.00	2,187,423.00	2,367,119.00	2,528,091.00
TOTALI	11,070,592.00	12,381,899.00	14,523,817.00	15,282,624.00

Punësimi

Në komunën e Kamenicës numri i të punësuarve në sektorin publik është 1140 të punësuar prej tyre 253 në administratë publike, 729 në arsim dhe 158 në shëndetësi.

Të dhënat nga Zyra Komunale e Punësimit në Kamenicë na tregojnë pasqyrën e punëkërkesve që janë të regjistruar.

Sipas këtyre të dhënave kemi 863 punëkërkes, 454 ose 53% meshkuj dhe 309 gra ose 47%.

Tabela 5. Gjinia e punëkërkesve

Kualifikimi i punëkërkesve	Femer	Mashkull
I pashkolluar	146	133
Shkolla fillore	40	44
Arsimi i mesem profesional	98	214
Shkollë e mesme – Gjinnaz	57	47
Bachelor	62	14
Master	6	2
PhD	0	0
Total	409	454

Grafiku 3. Gjinia e punëkërkesve




Tabela 6. Punëkërkesit sipas kualifikimeve

Kualifikimi i punëkërkesve	Numri i punëkërkesve	Përqindja
I pashkolluar	279	32.32%
Shkolla fillore	84	9.73%
Arsimi i mesem profesional	312	36.15%
Shkollë e mesme – Gjinnaz	104	12.05%
Bachelor	76	8.80%
Master	8	0.92%
PhD	0	0
Total	863	100%

Si punëkërkes të pakualifikuar konsiderohen ata që janë të pashkolluar, kanë përfunduar shkollën fillore ose edhe disa vite të shkollës së mesme, por që nuk kanë prova se zotërojnë ndonjë lloj profesioni. Fakti që kemi mbi 32% të punëkërkesve të pakualifikuar flet për nevojën e madhe që ata duhet të trajnohen në fusha specifike profesionale në Qendrën e Aftësimin Profesional në Gjilan.

Arsimi

Infrastruktura e shkollave është e mirë, objektet shkollore janë të përshtatshme për mbarëvajtjen e procesit edukativo arsimor, furnizimi me ujë, ngrohje, qasje në kanalizim, gjendja e objekteve, gjendja e inventarit është gjithashtu e mirë, dhe numri i klasave 256, posedimi i kabineteve shkencore apo hulumtuese 33.

Mesatarja e notës së nxënësve nëpër shkolla është ; Arsimi Fillor 4.54 , Arsimi i mesëm i ulët 4.05 , dhe Arsimi i mesëm i Lartë 3.61.Mesatarja e pikëve në testin e arritshmërisë është e dhënë në dokumentin më poshtë në tabelë.

Tabela 7. Numri i nxënësve

	Nr.institucioneve	Nr.nxënësve
Shkolla	21	3418
Çerdhe	2	144
Totali	23	

Gjithashtu në kuadër të IAAP „Andrea Durrsaku” në Kamenicë është edhe arsimi jo formal apo arsimi për të rritur në kuadër të të cilit mësimet i ndjekin 34 nxënës në këto drejtime; Elektroteknikë – profili informatikë 3 nxënës dhe Instalues elektrik 7 nxënës, Ndërtimtari 10nxënës, Makineri profile instalues i ujit ngrohjes dhe klimatizim 7- nxënës dhe metalpunues 7 nxënës. Por nuk përjashtohet mundësia që në të ardhmen të kemi dhe forma tjera të organizimit të arsimit joformal për aftsimin më të shpejt të kandidatve sipas kërkesës së tyre apo të kompanive të ndryshme të komunës sonë.

Shëndetësia

- 1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF),
- 3 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe
- 17 Njësi të Kujdesit Ambulantor-Ambulanca e Mjekësisë Familjare (AMF).

Nga 17 Njësi të Kujdesit Ambulantor, 12 prej tyre janë jashtë funksionit.

Funksionale janë ato në fshatrat:

1. AMF Koretin
2. AMF Topanicë
3. AMF Karaçevë
4. AMF Shipashnicë
5. AMF Bosce

Mosfunksionimi disa nga AMF- ve në disa fshatra është si pasojë e mungesës së stafit mjekësor ku kanë ndikuar dy (2) faktorë: migrimi i personelit mjekësor dhe ndarja e specializimeve e po ashtu edhe migrimi i banorve në qytet.

Tabela 8. Shërbimet e Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) – Kamenicë gjatë vitit 2022

Shërbimet shëndetsore	Numri i shërbimeve 2022
Numri i vizitave në QKMF	102359
Numri i përgjithshëm i shërbimeve shëndetsore	357705
Numri i vizitave shtëpiake	1198
Numri i shërbimeve të ofruara në kujdesin shtëpiak	7678
Numri i shërbimeve laboratorike	129938
Numri i shërbimeve radiologjike	4551
Numri i shërbimeve të mamografisë	1809

Kultura, Sporti dhe Rinia

Zhvillimi e jetës kulturore në përgjithësi në komunën tonë përfshinë disa fusha të artit si muzika, teatri, filmi, piktura, fotografia, këngët dhe vallet, letërsia etj. Gjatë një viti kalendarik, ky sektor mirret me shënimin e disa datave dhe manifestimeve tradicionale siç janë:

Flaka e Janarit, Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës (17 shkurti), Epopeja e UÇK-së (5-6-7 marsi), Lulëkuqet e Prillit, Qershori i Lirisë (18 qershori, Dita e Çlirimit të Kamenicës), Ditët e Diasporës, Dita e Flamurit (28 nëntori), si dhe data tjera të shënuara si: 1 Qershori – Dita e Fëmijëve, Dita Ndërkombëtare e Librit etj.

Në vitin 2023 është lansuar edicioni i parë i “Kamenica Summer Fest” ku janë organizuar shumë aktivete kulturore e sportive si: Motocross, Streetball, Beach volley, Koncert, Turne në futboll, Turne në shah, Stand up Comedy, Kinema verore, Ekspozita, Hiking etj



Foto 1. Kamenica Summer Fest – Gara në Motocross



Foto 2. Kamenica Summer Fest – Streetball



Foto 3. Kamenica Summer Fest – Beach Volley



Foto 4. Panairi i Prodhimeve Vendore

Sektori për Sport përveç menaxhimit që i bën Palestrës së Qytetit dhe Stadiumit të Qytetit “Agush Isufi” ku zhvillojnë aktivitet e tyre shumë klube sportive, mirret dhe ndihmon në organizimin e garave dhe turneve dhe ngjarjeve të ndryshme sportive komunale, regjionale e kombëtare



Foto 5. Kamenica Summer Fest – Turniri tradicional në futboll në Roganë

Në Komunën e Kamenicës funksionojnë gjithësej 16 klube sportive

- K.A. Rogana
- K.Rogana
- K.F. Kika
- K.F. Besa
- K.F. Dardana10
- K.V. Feniks F
- Klubi i Peshkimit Mlyshi
- Klubi i Badmintonit Arbëria
- Klubi i Karates Arbëria
- Shkolla e Futbollit Dardana
- Klubi i Shahut Dardana
- K.V. Feniks M
- Klubi I Badmintonit Rogana
- Klubi Triathlonit Dardana
- Klubi i Çiklizmit Dardana
- Klubi i Skijimit Kika

Sektori për Rini mirret me organizimin e aktiviteteve rinore me karakter edukativ, përmbajtësor; me qëllim të zhvillimit të mendimit kritik, aktivizimit qytetar, aftësive të buta, etj. Ky sektor organizon debate, kurse, trajnime, puntori, ekspozita, gara e lojra të ndryshme, aksione simbolike etj. Tashmë së fundi ka një focus akoma më të shtuar ndaj sektorit të rinisë, sepse me planet buxhetore ka një linjë të veçant të për financimin e aktiviteteve rinore.



Foto 6. Shfaqje e baletit



Foto 7. Aktivitete rinore

Në Komunën e Kamenicës gjinden më shumë se 40 asete të mbrojtura të trashëgimisë kulturore arkeologjike e arkitekturore. Zyra për Trashëgimi Kulturore në Komunën e Kamenicës, bën vizita sistematike nëpër keto lokalitete e objekte me qëllim të observimit të gjendjes dhe raportimit tek institucionet relevante qendrore, angazhohet në sigurimin e fondeve, nga

institucionet apo organizatat që mirren me trashëgimin kulturore, për konservimin dhe restaurimin e objekteve etj. Poashtu organizon ekspozita me motive nga trashëgimia jonë kulturore, vizita në terren me nxënës ose delegacione të ndryshme që vizitojnë komunën etj.

Në dokumentin **Lista e Trashëgimisë për Mbrojtje të Përkohshme** (Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport) nga Komuna e Kamenicës gjenden gjithësej 47 asete, prej tyre:

- 21 nga kategoria arkeologjike
- 22 nga kategoria arkitekturore
- 4 nga kategoria objekte të luajtshme



Foto 8. Trashëgimi kulturore – Kulla e Nuhi Berishës



Foto 9. Xhamia e Meshines

Ekonomia

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë ka për qëllim ndërtimin e kapaciteteve ekonomike të zonës lokale për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët, duke krijuar kushte të favorshme për bizneset lokale, promovuar potencialet për zhvillimin e turizmit dhe njëherit duke pasur një Diasporë shumë të fuqishme të shërbej në krijimin e urave lidhëse, përmes investimeve të Diasporës, me Komunën dhe qytetarët e saj.

Komuna e Kamenicës pronën komunale e jep në shfrytëzim për investitorë potencial të cilët idetë e tyre mund ti jetësojnë duke shfrytëzuar pronën komunale.

Numri i bizneseve të regjistruara dhe atyre aktive në komunën e Kamenicës ka mospërputhje pasi që shumë biznese janë të regjistruara por nuk janë aktive për arsye nga më të ndryshmet.

Tabela 9. Raporti i bizneseve të regjistruara dhe krahasimi ndër vite

Periudha	Biznese të regjistruara
2000-2018	2213
2000-2024	2902

Tabela 10. Ndarja e bizneseve të regjistruara në bazë të veprimtarive 2000-2024

	Biznese të regjistruara	
Veprimtaria	Nr. bizneseve	Përqindja %
Prodhuese	657	22.63%
Shërbyese	1029	35.45%
Tregtare	999	34.42%
Ndërtimore	217	7.47 %
	2902	100 %

Tabela 12. Krahasimi i bizneseve të regjistruara dhe të shuara mes vitit 2023 dhe 2024

Viti	Nr. bizneseve te regjistruara	Nr. bizneseve te shuara
2023	100	58
2024	98	31

Siguria

Siguria në Komunën e Kamenicës vlerësohet e qetë dhe stabile. Përveç institucioneve shtetërore, Komuna ka edhe Keshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Ky Këshill ka vizion

të përmirësimit të sigurisë dhe stabilitetit në bashkësi. Struktura e tyre përfshin një gamë të gjerë akterësh ndër-sektorial, të cilët luajnë një rol afatgjatë të rritjes së sigurisë në bashkësi.

KKSB-ja ka një qasje të gjerë në ofrimin e sigurisë si dhe përgjegjësve për ofrimin e një mjedisi të sigurt.

Bujqësia

Nga sipërfaqja e përgjithshme e Komunës së Kamenicës 58 % prej tyre janë tokë bujqësore, kurse 42 % janë sipërfaqe pyjore. Bujqësia në komunën tonë është sektori më i rëndësishëm, pasi që pjesa më e madhe e popullatës së komunës sonë është e angazhuar në këtë sektor. Gjendja e bujqësisë në komunën tonë karakterizohet me ferma të vogla, dhe mesatare 2.2 - 2.4 ha, të shpërndarë në 7 - 8 ngastra për fermë. Me prodhimtari nën mesatare të rajonit, pa mbështetje profesionale. Mbi 70 % e popullatës jeton në zonat rurale, dhe ekskluzivisht merren me bujqësi dhe pylltari

Sektorët e bujqësisë:

Lavërtaria - Prodhimtaria bujqësore

Sa i përket sektorit të lavërtarisë në komunën tonë kemi kultivimin e këtyre llojeve të drithërave si:

Tabela 13. Llojet e drithërave

Nr.	Lloji i Drithërave	Sipërfaqja në / ha.
1	Kultivimi i Grurit	mbi 2000
2	Kultivimi i Misërit	rreth 1200
3	Kultivimi i Elbit	100
4	Kultivimi i Tërshërës	150
5	Kultivimi i Thekrës	10



Blegtoria

Zhvillimi i blegtorisë në vend është në varëshmëri nga trendet e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit. Prej llojeve të kafshëve, më së shumti kultivohen lopë qumështore të llojit Laramanja e vendit, Sientali, Hollshtajni etj. dhe majmëria e viçave për trashje.

Tabela 14. Kultivimi i llojeve të kafshëve

Nr.	Lloji i Kafshëve	Numri i Krerëve
1	Kultivimi i lopëve qumështore	3000
2	Kultivimi i Mëshqerrave	500
3	Kultivimi i viçave për majmëri / trashje	400
4	Kultivimi i deleve qumështore	4,500
5	Kultivimi i qengjave	5,000
6	Kultivimi dhive qumështore	700
7	Kultivimi i keçave	900
8	Kultivimi dosave	500
9	Kultivimi gicave	1,500
10	Kultivimi i kuajve	50
11	Kultivimi i bletëve	9000
12	Kultivimi i shpezëve	55,000



Perimkultura

Kulturat perimëtare kultivohen në një sipërfaqe mbi 200 ha. (speci, domate, patate, shalqi etj. etj.) të cilat kultivohen në fushë të hapur dhe në serra. Në serra kultivohen; speci, domatja, trangulli, lakra, qepujka, llojet e sallatave të gjelbërta.

Tabela 15. Kultivimi i perimeve

Nr.	Lloji i Perimeve	Sipërfaqja në / ha.
1	Kultivimi i specit	50
2	Kultivimi i domatja	20
3	Kultivimi i patate	50
4	Kultivimi i trangujve	2
5	Kultivimi i qepës	15
6	Kultivimi i hudhërës	2
7	Kultivimi i lakrës	8
8	Kultivimi i shalqinit	50
9	Kultivimi i pjeprës	5
10	Kultivimi i kungullit dhe kungullit të misirit	30



Pemtaria

Pemët kultivohen në një sipërfaqe mbi 250 ha, (mollë, kumbull, dardhë, arra, lajthi) etj. Prej kulturave dominante janë molla dhe kumbulla, por vlen të ceket se kemi edhe shtim të arrës dhe lajthisë.

Tabela 16. Sipërfaqet e mbjella me pemë

Nr.	Lloji i Pemëve	Sipërfaqja në /ha.
1	Kultivimi i Mollës	100
2	Kultivimi i Dardhës	15
3	Kultivimi i Kumbullës	50
4	Kultivimi i Arrës	80
5	Kultivimi i Lajthisë	12
6	Kultivimi i pemëve të imëta (manore)	10

Tabela 17. Pylltaria

Nr.	Emërtimi i Pyjeve	Sipërfaqja në / ha.
1	Pyje Private	9,623
2	Pyje Publike	9,118
	Gjithsej	18,741

Ambienti

Komuna e Kamenicës ka një raport të mirë me ambientin, që fillon nga pjesa urbane e qytetit deri te shtrirja e vendbanimeve tjera në gjithë territorin e komunës. Rëndësia e një ambienti të pastër sot është sfiduese për të gjitha komunat e Kosovës, edhe Kamenica si të gjitha komunat e tjera përballë me disa problematika të menaxhimit të mbeturinave kryesisht ato inerte. Kamenica për nga sipërfaqja hyn në komunat e mëdha kryesisht me një relief i dominuar kodrinor-malor por nga numri i banorëve hyn në komunat me demografi mesatare. Mungesa e zhvillimit të industrisë ka ndikuar që kjo komunë të ketë ambient të pastër. Qyteti deri më tani ka ruajtur vijën ndërtimore dhe sot konsiderohej qytet i qet me një ambient të pastër dhe bukurinë e lumit Krivareka që e përshkon pjesën urbane. Në Kamenicë prodhohet energji e gjelbert 32 MË nga era dhe 3 MË nga energjia diellore.



Foto 10. Kamenica



Foto 11. Pamja nga zonat malore te Kamenices

Infrastruktura dhe Transporti

Komuna e Kamenicës shtrihet në Lindje të Kosovës. Pozita gjeografike e Komunës së Kamenicës është periferike në skajin më lindor të Kosovës, por është urë lidhëse në mes të Kosovës dhe komunave të Serbisë Jugore kryesisht të banuara me shqiptar. Komuna e Kamenicës shtrihet në regjionin Anamoravës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike sidomos për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit.

Nëpërmjet magjistrales Gjilan-Bujanoc, lidhet me qendrat tjera të Kosovës.

Kamenicë - Gjilan 30 km

Kamenicë - Prishtinë 71 km

Kamenicë – Shkup 108 km

Kamenicë - Tiranë 306 km

Kamenicë - Porti i Durrësit 318 km

Aeroportet më të afërta janë:

Aeroporti i Prishtinës 90 km dhe

Aeroporti i Shkupit 130 km.

Turizmi

Zhvillimi i turizmit përbën një potencial të rëndësishëm për zhvillimin lokal të Kamenicës, sepse ofertën turistike e përmbushin shumë elemente, ku në bashkveprim njëri me tjetrin rrisin produktet turistike, dhe kjo reflektohet edhe në qarkullimet turistike. Kamenica ka një sipërfaqe prej 416 km², me një relief kodrinoro-malor 60 %, ku në këtë formacion morfologjik shihet një pjesë e bukur e Gollakut, dhe lartësia më e lartë arrin në Gurin e Zi, 1223 m/lmd. Pikat tjera që janë të nivelit mbidetar rreth 1000 m/lmd, si Kika, Kranidelli, Busavata, japin një pamje të bukur të një pjese të Anamoravës, Maleve të Sharrit. Poashtu nga potenciali turistik natyror, janë edhe tre pellgje lumore, që shtrihen përgjatë gjithë teritorit si: Lumi i Desivojces, Krivarekes dhe Lumi i Hogoshtit.

Përgjatë shtreterve të tyre shtrihen shumica e fshatrave që e përbëjnë 90% të popullsisë. Në fshatin Rubovc, në afërsi të qytetit ekziston edhe Lugu i Verdhë, që karakterizohet me liqe artificial, shkëmbi i madh mbi liqe, shtigje të ecjes, çiklizmit, Parku i Aventurave. Oferten turistike të Kamenicës, e pasuron edhe trashëgimia kulturore, ku në gjithë hapësirën mund të vizitohet objekte arkeologjike të shekujve të para eres sonë, si Kalaja e Kulines, e cila është në pjesën veriore të qytetit, pastaj themele të kishave IliroInvestimet në agro-turizëm, eko-turizëm, turizëm kulturor turizëm sportiv, turizëm shëndetësor, janë disa mundësi të mëdha për investime në këto Kemi dhe shtrirjen infrastrukture. Si regjion deri më tani kjo hapësirë e Gollakut është e virgjër në ndërtimin e objekteve turistike, si bujtina, hotele etj.



Foto 12. Bujtina në Kranidell



Foto 13. Bujtina në Kikë



Foto 14. ZipLine – Lugu i Verdhë



Foto 15. Shtegu i ecjes



Foto 16. Maja e Kikës



Foto 17. Maja e Kranidellit

KONTAKTET

Adresa:

Rruga “Skenderbeu”, 62000 Kamenicë

Tel: 038 200 47628

Email: info.kamenica@rks-gov.net

web: <https://kamenice.rks-gov.net>

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Diasporë dhe Inovacion

Tel: 038 47 607